



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:090741

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753005

KA.nr.200/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit Trepça Sh. A. me seli në Parkun Industrial në Mitrovicë, kundër të paditurit Inspektorati i Punës – Shkalla e Dytë me seli në Prishtinë, me objekt të konfliktit administrativ anulimi i aktit administrativ, jashtë seancës, më 29 maj 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit Trepça Sh. A, kundër të paditurit Inspektorati i Punës – Shkalla e Dytë, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me nr. prot. 561 të datës 05.12.2023 të së paditurit.

A R S Y E T I M

Paditësi më 21.03.2024 ka paraqitur padi kundër të Paditurit, me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit nr. prot. 561 të datës 05.12.2023 të së paditurit Inspektorati i Punës – Shkalla e Dytë. Meqenëse paditësi nuk kishte bashkëngjitur padisë vërtetimin mbi pagesën e taksës gjyqësore, kjo gjykatë më datë 23.04.2024 paditësit ia ka dorëzuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore, ndërsa i njëjti e ka pranuar vërejtjen me datën 26.04.2024. Përmes asaj vërejtjeje Paditësi është paralajmëruar se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimi, atëherë gjykata do të veproj sipas nenit 253 para. 5 të LPK-së dhe nenit 5 lidhur me nenin 6 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor.

Në bazë të shkresave të lëndës gjykata konstaton se, Paditësi jo që nuk e ka paguar taksën gjyqësore brenda afatit të caktuar prej 15 ditëve, por ajo nuk është paguar as deri në ditën e marrjes së këtij aktvendimi. Kjo gjykatë gjithashtu gjeti se në shkresat e lëndës nuk ka prova, në

bazë të cilave do të mund të konstatohej se plotësohen kushtet ligjore nga nenet 468 deri 473 të LPK-së për lirim të Padiës nga shpenzimet procedurale.

Pasojat juridike të mos pagesës së taksës gjyqësore janë të rregulluara në nenin 253 para. 5 të LPK-së, sipas të cilit *“Në qoftë se padiësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padië as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr”*. Gjithashtu edhe neni 5 para. 5 nënpara 2 të Udhëzimit Administrativ 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor ka përcaktuar se *“Pala duhet ta paguajë taksën në afatin e caktuar nga gjykatësi, gjegjësisht kryetari i trupit gjykues, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 dite. Nëse kjo taksë nuk paguhet në kohën e caktuar, gjykata zbaton procedurat e parapara, si ne vijim: (...) 5.5.2 Nëse taksa për padi, e përcaktuar sipas vlerës së kontestit në padi, nuk paguhet deri në datën përfundimtare, edhe pas pranimit të vërejtjes për pagesën e saj, në rastet kur nuk ekzistojnë kushtet për lirim të palës nga detyrimi i pagesës, do të zbatohet neni 253 paragrafi 5 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ashtu që do të konstatohet se padia është tërhequr*.

Për këto arsye, gjykata e konsideron të tërhequr padiën e Padiësve dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.200/24

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.